

Në bazë të Programit për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit, për vitin 2022 (Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit numër 2/22), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE
për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për financimin e programeve,
projekteve, aktiviteteve dhe manifestimeve në fushën e sportit me interes
për Qytetin e Shkupit për vitin 2022

Përcaktimi strategjik i Qytetit të Shkupit për mbështetjen e sportit është që nëpërmjet programeve, projekteve, manifestimeve, aktiviteteve dhe thirrjeve publike të inkurajojë zhvillimin e sportit, si dhe afirmimin e Qytetit të Shkupit si një qendër e zhvilluar sporti me karakteristika evropiane që janë adekuate me statusin e tij si kryeqytet, me qëllim realizimin e interesit publik me rëndësi lokale në fushën e sportit.

Qyteti i Shkupit me qëllim të organizimit, inkurajimit dhe ndihmesën për manifestimet sportive dhe evenimentet me rëndësi për Qytetin, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e cilësisë së sportit, shpall këtë thirrje publike.

Aktivitetet sportive, programet dhe manifestimet dhe mjetet financiare për realizimin e tyre, Qyteti i Shkupit i përcakton me programin vjetor gjë me të cilën shprehet interesi dhe nevojat në këtë sferë.

Mjetet për financimin e programeve dhe projekteve do të sigurohen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2022.

1. Përshkrim i shkurtër i Programit dhe llojit të projekteve të cilat do të mbështeten

Në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteret për përcaktimin e Programit për sport dhe për sigurimin e mjeteve për realizimin e tyre, si dhe mbi bazën e vlerësimeve për programet e realizuara në vitin 2021, Qyteti i Shkupit me Programin e aktiviteteve nga fusha e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2022, me katër (4) kapitujt e mëposhtëm të Programit, do të mbështesë:

a) MANIFESTIME TRADICIONALE SPORTIVE

Qyteti i Shkupit do t'i financojë manifestimet tradicionale sportive të karakterit lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim ruajtjen e vazhdimësisë së këtyre manifestimeve për të cilat ka interesim nga ana e qytetarëve dhe që janë në interes të zhvillimit të sportit në qytetin e Shkupit, me mjete nga Buxheti i Qytetit të Shkupit, të alokuara organizatorit (Federata Kombëtare e Sportit, anëtare e Federatës Kombëtare të Sportit dhe subjekteve të tjera sportive).

Vetë emri manifestime sportive tradicionale tregon se Qyteti i Shkupit do të financojë manifestime të cilat kanë një traditë të paktën pesë vjeçare dhe që kanë lënë gjurmë të thella në zhvillimin e sportit në Shkup.

b) MANIFESTIME ME INTERES TË VEÇANTË PËR QYTETIN E SHKUPIT

Në fushën e manifestimeve me interes të veçantë, Qyteti i Shkupit do t'i financojë programet, projektet dhe aktivitetet e të gjitha subjekteve të interesuara sportive dhe subjekteve që organizojnë aktivitete sportive për persona me nevoja të posaçme, të cilat do të depozitojnë programe, projekte dhe aktivitete për organizimin e manifestimeve dhe evenimenteve sportive me interes të veçantë për Qytetin e Shkupit.

c) MBËSHTETJA E PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE TË ORGANIZATAVE TË TJERA SPORTIVE ME INTERES PËR QYTETIN E SHKUPIT

Qyteti i Shkupit do t'i financojë programet, projektet dhe aktivitetet për realizimin e programeve të veçanta për krijimin e kushteve për realizimin e aktiviteteve sportive të sportistëve amatorë, të nxënësve dhe të rinjve, me theks të veçantë në realizimin e aktiviteteve sportive dhe garave të nxënësve në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit. Qyteti i Shkupit do t'i mbështesë edhe programet gjinore, projektet, aktivitetet dhe manifestimet.

Qyteti i Shkupit do t'i mbështesë iniciativat dhe aktivitetet për zhvillimin e disiplinave sportive që nuk janë të pranishme në Qytet, dhe që zënë një vend të rëndësishëm në manifestimet ndërkombëtare si dhe në jetën sportive në kryeqytete dhe qendra të mëdha urbane në botë.

Mundësimi i komunikimit më intensiv të sportistëve dhe sportistëve dhe shoqatave të tyre me sportistët nga qytetet e vëllazëruara, kryeqytetet dhe qendrat e mëdha urbane në rajon dhe në botë, me qëllim avancimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë.

Qyteti i Shkupit do t'i mbështesë edhe aktivitetet rekreative-sportive të personave me nevoja të posaçme në territorin e qytetit të Shkupit.

ç) AKTIVITETE SPORTIVE TË PËRCAKTUARA NË MËNYRË PLOTËSUESE

Qyteti i Shkupit do t'i financojë programet, projektet, aktivitetet dhe manifestimet që nuk janë të përfshira me pozicionet e mëparshme të pikave të lartpërmendura, dhe të cilat me aktualitetin, atraktivitetin, rëndësinë dhe cilësinë e tyre, kontribuojnë për realizimin e qëllimeve programore në fushën e sportit të Qytetit të Shkupit për vitin 2022.

Programet dhe projektet e propozuara, aktivitetet programore dhe manifestimet, përveç arsytimit duhet të përmbajnë edhe propozim konstruksionin financiar, në të cilin do të theksohen mjetet që kërkohen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit, si dhe mjetet e siguruara nga Agjencia për të Rinj dhe Sport e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të ardhurat e veta dhe mjete nga burime të tjera.

2. Kushte të përgjithshme dhe kriteret

Përveç fushave të lartpërmendura, aplikimet e depozituara duhet t'i përmbushin qëllimet dhe kriteret të cilat janë dhënë të bashkëngjitura në Thirrjen Publike, që është shpallur në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Në procedurën për shpërndarjen e mjeteve buxhetore nga Programi për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2022, do të pranohen ato programe dhe projekte, aktivitete programore dhe manifestime që në bazë të kriterëve do të sigurojnë më së paku **55** pikë.

3. Mënyra e aplikimit dhe dokumentacioni i detyrueshëm

Aplikimi në Thirrjen Publike kryhet me depozitimin e aplikimit të plotësuar. Aplikuesi, përveç aplikimit, në mënyrë të detyrueshme duhet t'i depozitojnë dhe dokumentet e mëposhtme:

- aktvendim për regjistrimin në regjistër dhe gjendja aktuale për veprimtarinë e regjistruar jo më të vjetër se gjashtë muaj, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- vërtetim për xhiro llogari të hapur dhe aktive me bankën dhe
- në varësi të statusit të aplikuesit, të depozitohet Vendim për kryerjen e veprimtarisë sport, të lëshuar nga Agjencia për të Rinj dhe Sport.

4. Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve

Të dhënat e nevojshme si dhe propozim programet dhe projektet, aktivitetet programore dhe manifestimet, me konstruksionin financiar, duhet të depozitohen në aplikim të veçantë që mund të merret nga Arkivi i Qytetit të Shkupit (baraka 16) ose të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Thirrja publike zgjat **15 ditë kalendarike**, nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.
Thirrja Publike shpallet më 14.03.2022 dhe zgjat deri më 28.03.2022.

Aplikimet duhet të depozitohen pranë Qytetit të Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. "Ilinden" numër 82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni deri më datën **28.03.2022** deri në orën **15:00** ditën e fundit të përfundimit afatit të Thirrjes publike, me shënimin "**Thirrje Publike për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për financimin e programeve, projekteve aktiviteteve dhe manifestimeve nga fusha e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2022**".

Aplikimet depozitohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, pa shënuar subjektin i cili depoziton aplikimin.

VËREJTJE: Aplikimet e parregullta të cilat nuk janë depozituar në mënyrën që kërkohet në tekstin e mësipërm, gjegjësisht përmbajnë të dhëna të paplota dhe dokumentacion të pakompletuar, si dhe ato që nuk do të depozitohen në afatin e caktuar, nuk do të shqyrtohen.

Informacione plotësuese mund të merren në tel: 3297-238 dhe 3297-320.

**QYTETI I SHKUPIT
KRYETARJA E QYTETIT TË SHKUPIT**